

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE NGRITJE NË DETYRË DHE PRANIM
NË SHËRBIMIN CIVIL PËR KATEGORINË E ULËT DREJTUESE
(Përgjegjëse, Sektori i Kontrollit Zhvillimit të Tokës, Infrastrukturës dhe Mjedisit në
Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve)**

Në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Bashkia Elbasan shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të ngritjes në detyrë për pozicionin:

“Përgjegjëse, Sektori i Kontrollit Zhvillimit të Tokës, Infrastrukturës dhe Mjedisit në Drejtorinë e Planifikimit të Territorit dhe Projekteve ”.. - Kategoria IIIA/1

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

PËR TË TRE PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË

Afati për dorëzimin e dokumentave për LËVIZJE PARALELE: **28.04.2019**

Afati për dorëzimin e dokumentave për NGRITJE NË DETYRË: **03.05.2019**

PËRSHKRIMI PËR GJITHËSUES I PUNËS PËR POZICIONIN SI MË SIPËR ËSHTË –

- Merr masa organizative për plotësimin e detyrave nga çdo zyrë e punonjës në veçanti dhe si sektor brenda planifikimit të detyrave të drejtorisë.
- Evidenton problemet që dalin nga veprimtaria e përditëshme, si dhe çështjet e ndryshme që ngrihen me shkrim nga qytetarët, përcakton zgjidhjet e mundshme brenda kuadrit ligjor në fuqi dhe i propozon drejtorit rrugëzgjdhjet përkatëse.
- Koordinon kryen studime për fusha të ndryshme dhe organizon sistemin e informacionit për sektorin që mbulon.
- Organizon sistemin e administrimit të informacionit dhe të statistikave për veprimtarinë e sektorit.
- Bën vlerësime pune për nëpunësit dhe punonjësit e sektorit.

1. Lëvizja Paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 Kushtet për lëvizjen paralele dhe Kriteret e vecanta

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a. Të jenë nëpunës civil te konfirmuar, brenda të së njëjtës kategori IIIA/1
- b. Të mos kenë masë disiplinore në fuqi
- c. Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”
- d. Të plotësojë kushtet dhe kerkesat e posaçme, të përcaktuara në shpalljen për konkurim

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a- Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" . Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b- Të kenë të paktën 3 vite përvojë pune;

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a - Jetëshkrim i personit (CV)
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g - Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h - Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i - Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për lëvizjen paralele duhet të bëhet brenda datës: **28.04.2019** pranë Bashkisë Elbasan, dorazi apo me poste.

1.3 REZULTATET PER FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **30.04.2019**, NJBNJ do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” stendat e informimit publik dhe faqen e internetit te Bashkise Elbasan listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurë levizjes paralele në kategorinë e ulët drejtuese, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën date kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Njesia e Menaxhimit te Burimeve Njerezore, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Ligjin 139/2015 “Per vetëqeverisjen vendore”
- b) Njohuritë mbi Ligjin 152/2013 “Për nënpunësin civil” I ndryshuar.
- c) Ligji nr.8402, date 10.09.1998 për “Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” I ndryshuar
- d) Ligjin nr.8405 datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” I ndryshuar
- e) Ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”
- f) Ligji nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer.

Totali i pikeve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Elbasan do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të saj dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*).

2. NGRITJA NË DETYRË

Në rast se pozicioni i cituar në fillim të kësaj shpalljeje, nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, vazhdon procedura e ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në faqen e internetit të Bashkisë Elbasan dhe stendat e informimit qytetar, duke filluar nga data **13.05.2019**

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët) të punësuar në të njëjtin apo institucion tjetër të shërbimit civil që plotësojnë kriteret për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lire.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- a. Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda kategorisë IIIB
- b. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c. Të ketë vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë mirë”

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a - Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" . Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- b- Të kenë të paktën 3 vite eksperiencë pune

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët (nëpunës civilë) që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim I plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://ëëë.dap.gov.al/legjislacioni/udhëzime-manuale/60-jetëshkrimi-standart>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë)
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID)
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore

f-Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore
g-Vlerësimin e fundit nga eprori direkt
h-Vërtetim nga eprori që nuk ka masë disiplinore në fuqi
i-Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet positive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj
Kandidatët (Jashtë Shërbimit Civil) që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a-Jetëshkrim

b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;

c-Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë)

d-Fotokopje të letërnjoftimit (ID)

e-Vërtetim të gjendjes shëndetësore

f-Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave për procedurën e ngritjes në detyrë në kategorinë e ulët drejtuese duhet të bëhet brenda dates **03.05.2019**.

Dokumentacioni dorëzohet dorazi apo me postë në zarf të mbyllur pranë Bashkisë Elbasan.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **13.05.2019**, Njësia e Burimeve Njerezore do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, stendat e informimit publik dhe faqen e internetit të Bashkisë Elbasan listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e ngritjes në detyrë në kategorinë e ulët drejtuese, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën date kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Njësia Përgjegjëse, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

2.4 FUSHAT E NOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- b) Njohuritë mbi Ligjin 152/2013 “Për nënpunësin civil” I ndryshuar.
- c) Ligji nr.8402, date 10.09.1998 për “Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” I ndryshuar
- d) Ligjin nr.8405 datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” I ndryshuar
- e) Ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”
- f) Ligji nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e Etikës në Administratën Publike”

2.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;

b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;

c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, NJBNJ do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” stendat e informimit publik dhe faqen e internetit të Bashkisë Elbasan. Të gjithë kandidatet pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (*nëpërmjet adresës së e-mail*)

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë, do të marrin informacion në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak
- Datën, orën dhe vendin në të cilën do të zhvillohet konkurimi

Për të marrë këtë informacion duhet të vizitoni në mënyrë të vazhdueshme faqen zyrtare të bashkisë dhe portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit duke filluar nga data **13.05.2019**.